REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
MUNICIPALITY OF LIPJAN
SKUPŠTINA LIPLJAN

**DREJTORATI PËR PLANIFIKIM, URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT**

| | |
|---|---|
| Datë: | 05.10.2020 |
| Referencë: | ZR |
| Për: | Imri Ahmeti- Kryetar i Komunës |
| Kopje: | Fauz Xhemajli – Nënkryetar i Komunës<br>Lulzim Qerimi – Nënkryetar i Komunës |
| Nga: | Emina Rexhiq – Drejtoreshë e DPUMM |
| Lënda: | **RAPORT** |

Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, bazuar në detyrat dhe obligimet gjatë procesit të punës dhe aktivitetet e përgjithme të zhvilluara në kuadër të Drejtoratit prezenton:

**RAPORTI I PUNËS**
**PËR PERIUDHËN RAPORTUESE**
**01.09.2020-30.09.2020**

# PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë periudhës raportuese DPUMM ka zhvilluar aktivitetet si:

Është përgaditur materiali për publikim në faqen zyrtare të Komunës – Harta Zonale e Komunës së Lipjanit dhe Raporti I VSM.
Njoftimi për shqyrtim publik I publikuar ne faqen zyrtare të Komunës dhe definimi I prezentimeve publike gjithsejt 6 prezentime publike , 4 në qytetin e Lipjanit dhe dy prezentime në zonat rurale , Magurë dhe Gadime, I cili është planifikuar të zgjasë 30 ditë, duke filluar nga 18 shtator deri me 19 tetor 2020.
Gjatë kësaj kohe janë zhvilluar gjithsejt 4 prezentime publike me qytetarë, dhe jane diskutuar zonat urbane të qytetit të Lipjanit.
Gjithashtu janë konsultuar në vazhdimësi të gjithë të interesuarit gjatë ditëve që nga fillimi i procesit , të cilët kanë paraqitur kundërshtimet dhe sygjerimet në Librin e vërejtjeve si dhe përmes shkresave zyrtare .
Pjesëmarrja e qytetarëve gjatë këtij procesi ka qenë mjaft e kënaqshme , që ka rezultuar me interesim dhe pjesëmarrje gjatë tërë kësaj kohe .
Gjate ketij procesi vlen te theksohet se kundërshimet kryesisht jane potencuar ne destinimin e zonave dhe kriteret për kushtet ndertimore si:
Kriteri i cili është propozuar për zonat me dendësitet të lartë dhe zonat me dendesi te mesme si sipërfaqja e parcelës, balli i parcelës dhe koeficienti, jane e kundershtuar destinimet ne zonat ZUP-1 dhe ZUP-5, ZUL-6 te cilat janë diskutuar si mundësi ridestinimi.
Gjithashtu rruget e planifikuara , te cilat eshte kerkuar qe te jene ne harmoni me gjendjen faktike dhe mundesi riplanifikimi , kryesisht ne zonat e ndertuara.
Ne zonat ZUL-6 dhe ZUL-4 , eshte kundershtuar pjesa e cila eshte planifikuar si zone e lire , ne kete rast eshte diskutuar mundesi destinimi sipas gjendjes ne zone , duke iu pershtatur trasese se rruges unazore .
Zonat ekonomike ne kuader te zones urbane eshte diskutuar apo kundershtuar gjenjda e planifikuar pasi qe kerkohet qe ato te jene sipas gjendjes se meparshme , si dhe Zona e cila eshte destinuar sipas vendimit te Kuvendit , si zone banimi per kategorite e dala nga lufta .
Nga ky proces i zhvilluar deri me tani si pjesemarrja e publikut dhe perkushtimi i stafit te DPUMM qe mund te vleresohet si proces mjaft pozitiv duke iu referuar pjesemarresve deri me tani rreth 120 pjesëmarrës, dhe se krijon kushte per mundesi riplanifikimi dhe finalizimi te dokumentit duke pase parasysh kundershtimet ne kete faze dhe ne disa raste jane mjaft te arsyeshme dhe paraqesin baze per rregullim.

Kërkesat për Certifikatë legalizimi janë trajtuar kryesisht kerkesat per Kategorinë e I-rë ndërtimore , ndërsa kerkesat që kanë të bëjnë me Kategorinë e II- të ndërtimore gjithsejt jane 22 kërkesa të cilat nuk janë trajtuar, këto raste planifikohen të trajtohen përmes një Komisioni I cili do te realizoje fazën inspektuese.
Gjate muajit shtator DPUMM ka marrë pjesë në trajnimin virtual I organizuar nga MEA lidhur me procesin e legalizmit – regjistrimi I objekteve ne RDPP.
Projektet komunale – konsultime me Drejtoratet relevante rreth hartimit dhe implementimit .

Gjate muajit shtator DPUMM ka pranuar gjithsejt 53 kërkesa/lënde, si dhe lendet e bartura nga periudha paraprake 64 lende qe rezulton ne gjithsejt në procedurë shqyrtimi 117 lëndë

Nga këto të dhëna nga të gjitha kërkesat e pranuara dhe kerkesat e bartura gjate kesaj periudhe jane shqyrtuar gjithsejt 43 kërkesa, prej tyre të miratuara 35 kërkesa, të refuzuara 3 kërkesa, të bartuar në sektorë tjerë 5 kërkesa .

Në procedurë të shqyrtimit janë gjithsejt 74 lëndë, si vijon:
46 .....Leje legalizimi
8 .....Kushte ndertimore
9..... Leje ndërtimi
0……..Leje rrënimi
1 ……..Certifikatë përdorimi
10 ……..Kërkesa tjera

DPUMM gjatë muajit gusht ka realizuar të hyra, që ndërlidhen me procesin e Lejeve në vlerë prej 157,554.13€.

Projektet komunale , te cilat jane planifikuar te implementohen per vitin 2020 ,procesi I hartimit si vijon:

| Nr. | Titulli I projektit | Statusi |
|---|---|---|
| 1 | Asfaltimi i rrugës Slloovi –Akllap | Projekti I dorëzuar |
| 2 | Asfaltimi i rrugësve në Marevc dhe Gllavicë | - //- |
| 3. | Implementimi projektit – shtepia e komunitetit ne Janjeve | Ne process |
| 4. | Pjesemarrja ne Komision per rrugen “Shqiperia” dhe Haradin Bajrami” Lipjan | Ne process |

## STATISTIKAT

Pranimi dhe Shqyrtimi i kërkesave të parashtruara nga palët

| Nr. | Llojet e kërkesave | Nr i kërkesave te pranuara gjatë muajit korrik | Nr. I kërkesave nga periudha e kaluar | Të Pezulluara | Miratuara | Refuzuara | Të bartura në sektor tjera | Në procedurë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Kushte ndërtimore | 3 | 8 | - | 3 | - | - | 8 |
| 2 | Leje ndërtimi | 7 | 5 | - | 3 | - | - | 9 |
| 3 | Leje rrënimi | - | 1 | - | - | - | - | - |
| 4 | Certifikatë perdorimi | - | 1 | - | - | - | - | 1 |
| 5 | Certifikate legalizimi | 18 | 40 | - | 10 | 3 | - | 46 |
| 5 | Kërkesa të tjera | 25 | 9 | - | 19 | - | 5 | 10 |
| | **Gjithsejt** | **53** | **64** | **-** | **35** | **3** | **5** | **74** |

**DISKUTIME PUBLIKE**

Gjatë periudhës raportuese DPUMM ka zhvilluar gjithsejt 4 prezentime publike që ndërlidhen me procesin e Shqyrtimit publik të HZK.

## SFIDAT

Numer i vogel i aplikimeve per Certifikatë Përdorimi.
Kerkesat e reja për Kushte ndërtimore dhe Leje ndërtimore – procesi i shqyrtimit publik te HZK.
Procesi i legalizimit , objektet e Kategorisë së II-të

**Rekomandime**

Formimi i Komisionit për trajtimin e ndërtimeve pa leje për ndertimet e Kategorisë së II-të.
Përgaditja e Raportit nga procesi i shqyrtimit publik të HZK dhe procesi i trajtimit te ankesave të prezentuara gjate procesit, ne bashkëpunim me EKK, EKP , GIZ dhe DPUMM.